



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.06, datë 28.01.2026

“MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËM EKONOMIKE”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 28.01.2026, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 30/1 të ligjit nr.57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, V.K.M nr. 597, date 04.09.2019, kreu IV, “Për përcaktimin e proceduarve të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike

VENDOSI:

I- Miratimin e kriterëve për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga Fondi i Kushtëzuar për Blok-Ndhmën si më poshtë:

- 1- Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
- 2- Familje më kryefamiljare gra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
- 3- Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune.
- 4- Familje me shumë fëmijë.
- 5- Familje që kanë përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin universitetin.
- 6- Familje që kanë përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi /invalide pune.
- 7- Familje që kanë një anëtarë dhe janë të braktisur ose të vetmuar.

II- Dokumentat e aplikuesëve të jenë sipas VKM nr.597 datë 04.09.2019 ‘Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

III- Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr.597, date 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Vendimi u miratua me 11 Vota pro, vota kundër - s’ka , abstenim – s’ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Elsa PETRITAJ

